



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 275/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.05.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Moto Mania” sh.p.k, në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-50392-02-22-2018, me objekt: “*Blerje ilaçe stomatologjike për vitin 2018*”, me fond limit 5.569.872 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 09.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Klinika Stomatologjike Universitare.

Ankimues:

“Moto Mania” sh.p.k
Rruga “Demneri” pranë shkollës “Nobel”, Godina nr.1, Mëzez, Kamëz,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Klinika Stomatologjike Universitare
Rruga e Dibrës, brenda QSUT,
Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.02.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me Nr. Ref-50392-02-22-2018, me objekt: “*Blerje ilaçe stomatologjike për vitin 2018*”, me fond limit 5.569.872 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 09.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Klinika Stomatologjike Universitare.

II.2. Në datën 09.03.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si më poshtë vijon:

- | | |
|------------------------|---------------------------------|
| 1. “Moto Mania” sh.p.k | 5.018.172,00 lekë, skualifikuar |
| 2. “Marlen/E” sh.p.k | 5.484.772,00 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik ankimues “Moto Mania” sh.p.k, është njoftuar elektronikisht mbi skualifikimin e tij pasi:

“*Ne lidhje me kapacitetin teknik pika 2.3 te kriterëve per kualifikim te kerkuara ne shtojesen 8, kompania nuk ploteson piken 1 Kontrata te ngjashme te tre viteve ne fundit ne nje vlere jo me pak se 2 227 948 leke, pasi:*

1. Fatura tatimore e shitjes me numer 780, date 18.09.2017, me bleres Drejtorine Rajonale te Shendetesie Elbasan eshte e pa shoqeruar me vertetim realizimi kontrate ne kundershtim me kriterin e percaktuar ne DT pika 2.3 .1 .a Per furnizime te ngjashme te realizuara me autoritetet kontraktore, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim realizimi leshuar nga enti publik si dhe fature tatimore ku shenohen datat shumat dhe sherbimet e realizuara.

2. Fatura tatimore Nr. 1090, date 04.12.2017 ne emer te subjektit Drenica Bashkurti eshte e pa shoqeruar me listen e materialeve, pra eshte e pa mundur identifikimi i zerave te faturuar.

3. Fatura tatimore e shitjes Nr. 624, date 25.07.2017 me bleres Drejtorine Rajonale te Shendetit Publik Durres, eshte e pa shoqeruar me vertetim realizimi kontrate ne kundershtim me kriterin e percaktuar ne DT pika 2.3 .1 .a Per furnizimete ngjashme te realizuara me autoritetet kontraktore, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim realizimi leshuar nga enti publik si dhe fature tatimore ku shenohen datat shumat dhe sherbimet e realizuara.

4. Faturat te cilat jane te rregullta jane fatura me nr. 1310, date 16.12.2016 me vlere 1 489250 leke me DSHP Shkoder e cila eshte e shoqeruar me me veretim realizimi+ fatura tatimore me kliniken dentare AK Farke date 12.01.2018, me vlere 43 333 leke + fatura tatimore me bleres Aldida Jaze me Nr. 1086, date 02.12.2017 me vlere 10324 lekë.

Totali i vleres se faturave te rregullta eshte 1 542 907 leke.

Pra operatori ekonomik nuk ploteson kriterin e vleres se kontrates se ngjashme e cila referuar kriterëve per kualifikim duhet ne vleren jo me pak se 2 227 948 leke.”

II.3. Në datën 13.03.2018 operatori ekonomik ankimues “Moto Mania” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 82/1 prot., datë 15.03.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.5. Në datën 21.03.2018 operatori ekonomik “Moto Mania” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor

II.6. Në datën 30.03.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 567/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 88/1 prot., datë 29.03.2018 me objekt: “Dërgim informacioni”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Moto Mania” sh.p.k se: “[...] operatori ekonomik nuk ploteson kriterin e vleres se kontrates se ngjashme e cila referuar kriterëve per kualifikim duhet ne vleren jo me pak se 2 227 948 leke”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 1, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

“1. Kontrata te ngjashme te tre viteve te fundit me vlere jo me pak se 2 227 948 leke. Per kete operatori ekonomik duhet:

a. Per furnizime te ngjashme te realizuara me autoritetet kontraktore, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim realizimi leshuar nga enti publik si dhe fature tatimore ku shenohen datat shumat dhe sherbimet e realizuara.

b. per furnizimet e ngjashme te realizuara ne sektorin privat, operatori ekonomik duhet paraqese fature tatimore te shitjes se mallit ku shenohen datat shumat dhe sherbimet e realizuara.”

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Moto Mania” sh.p.k. të depozituar për këtë procedurë prokurimi në sistemin elektronik të prokurimeve, rezulton se për të plotësuar kriterin e sipërpërmendur ka paraqitur:

1. Vërtetim lëshuar në datën 15.06.2017 nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër, sipas të cilit vërtetohet se subjekti “Moto Mania” sh.p.k [...] ka realizuar kontratën me nr. 2189 prot., datë 13.12.2016 me objekt: “Blerje materiale mjekimi stomatologjike”, me vlerë 1.706.880 lekë me tvsh. [...] Kontrata është realizuar me sukses, duke plotësuar specifikimet teknike dhe afatet e lëvrimit të mallit.

Ky vërtetim është shoqëruar me faturën tatimore si më poshtë:

- Faturë tatimore shitje, datë 16.12.2016 me vlerë 1.489.250. lekë pa tvsh dhe 1.706.880 lekëme tvsh.
2. Faturë tatimore shitje për Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë Elbasan datë 18.09.2017 me vlerë 330.400 lekë pa tvsh, për materiale dentare sipas faturës bashkëngjitur.
 3. Kontratë furnizimi “Blerje materiale konsumi për klinike dentare” e lidhur në datën 21.06.2017 me autoritetin kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës e cila përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kontartës dhe është shoqëruar me:
 - Faturë tatimore shitje, datë 25.07.2017 me vlerë 1.200.050 lekë pa tvsh, për materiale dentare sipas faturës bashkëngjitur.
 4. Faturë tatimore shitje për Klinikën Dentare AMC datë 12.01.2018 me vlerë 43.333 lekë pa tvsh.
 5. Faturë tatimore shitje për subjektin Drenica Bashkurti datë 04.12.2017 me vlerë 45.958 lekë pa tvsh.

6. Faturë tatimore shitje për subjektin A.Baze, datë 02.12.2017 me vlerë 10.364 lekë pa tvsh.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
- Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.5. Referuar dokumentacionit sa më sipër të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, Komisioni gjykon se fatura tatimore e shitjes për autoritetin kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Elbasan me datë 18.09.2017 dhe me vlerë 330.400 lekë pa tvsh, si dhe dokumentacioni i paraqitur për shitjet e realizuara me autoritetin kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Durrës, si më sipër cituar, nuk janë shoqëruar me vërtetim realizimi, në kundërshtim me kushtin e vendosur nga autoriteti kontraktor që për furnizime të ngjashme të realizuara me autoritetet kontraktore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim realizimi leshuar nga enti publik si dhe fatura tatimore ku shënohen datat shumat dhe sasi të mallrave të realizuara.

Dokumentacioni i paraqitur për shitjet e realizuara me autoritetin kontraktor Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Shkodër me vlerë 1.489.250 lekë pa tvsh si dhe faturat tatimore të shitjes për Klinikën Dentare AMC me vlerë 43.333 lekë pa tvsh, për subjektin Drenica Bashkurti me vlerë 45.958 lekë pa tvsh dhe për subjektin A.Baze, me vlerë 10.364 lekë pa tvsh, pavarësisht se janë paraqitur në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor përsa i përket dokumentacionit që vërtetojnë kryerjen e këtyre shitjeve, nuk plotësojnë kushtin e vendosur në kriteret e kualifikimit që ekperiencat e

mëparshme te tre viteve te fundit të jenë me vlere jo me pak se 2 227 948 lekë, pasi vlera e tyre në total është 1.588.905 lekë.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon se: "[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]". Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Akoma më tej, sqarojmë se në rast se ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se: "*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*".

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues, do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se:

"[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]".

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Moto Mania” sh.p.k në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Moto Mania” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-50392-02-22-2018, me objekt: “Blerje ilaçe stomatologjike për vitin 2018”, me fond limit 5.569.872 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 09.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Klinika Stomatologjike Universitare.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 567 Protokolli;

Datë 21.03.2018



Public Health Sector

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha